



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

39824

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 12. 11. 2025

Lënda: Njoftohet vendimi i mosfillimit.

Drejtuar: Z. Idajet Beqiri

Kutia postare nr: 8288.

TIRANË

Bashkëlidhur, po Ju dërgojmë një kopje të njehsuar me origjinalin të vendimit të mosfillimit të procedimit penal mbi bazën e materialit kallëzues nr: 293 i vitit 2025.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTUESI I PROKURORISË

ALTIN DUMANI

ME URDHËR DHE ME DELEGIM

**PROKURORI I ÇËSHTJES
EDVIN KONDILI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

V E N D I M

“Për mosfillimin e procedimit penal”

Në Tiranë, më 07.11.2025.

Unë Edvin Kondili, Prokuror në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, pasi u njoha me materialin kallëzues nr. 293 të datës 07.11.2025,

K O N S T A T O V A

Më datë: 23.10.2025, në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Tiranë, është regjistruar materiali kallëzues Nr: 37636 që bën fjalë për kryerjen e veprave penale të “Kryengritjes së armatosur”, “Vepra me qëllime terroriste”, “Organizata kriminale” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 221, 230, 333 dhe 334 të Kodit Penal.

Ky kallëzim penal është depozituar nga shtetasi Idajet Beqiri në ngarkim të shtetasve Sali Berisha, Ritvan Bode, Genc Pollo, Shaban Memia, Pal Dajçi, Ekrem Spahiu, Alfons Zeneli, Artur Bejzade Frrok Gjini, Dem Dollapi etj, për të cilët ka dyshime se kanë kryer një grusht shteti me anë të kryengritjes së armatosur dhe veprave me qëllim terroriste, në formën e posaçme të bashkëpunimit, të organizatës kriminale, në lidhje me ngjarjet e datës 14 shtator 1998.

Më konkretisht, kallëzuesi parashtron se në 14 shtator 1998 Partia Demokratike dhe kryetari i saj, Sali Berisha, kryen një kryengritje të armatosur dhe disa akte terroriste. Grushti i shtetit i 14 shtatorit 1998 nuk ishte akt spontan, një shpërthim emocional i revoltës së militantëve të Partisë Demokratike pas vrasjes së deputetit Azem Hajdari. Ai u përgatit me shumë kujdes e për një kohë të gjatë, në çdo detaj të tij.

Në 29 qershor 1997 u bënë zgjedhjet e përgjithshme parlamentare. Koalicioni “Aleanca për Shtetin” i udhëhequr nga Partia Socialiste i fitoi ato me mbi 60 përqind të votave të shqiptarëve. Partia Demokratike pësoi një humbje të thellë. Ajo mori vetëm 25.7 për qind të votave. Më pak se gjysmën e votave që mori Partia Socialiste. Sali Berisha e kontestoi rezultatin e zgjedhjeve që të nesërmen e zhvillimit të tyre. Partia Demokratike dhe Sali Berisha nuk u pajtuan dot me humbjen e pushtetit dhe rotacionin politik të pushtetit. Që të nesërmen e zgjedhjeve ata filluan të mendojnë e të përgatiten për rimarrjen e tij me çdo mjet, përfshirë edhe përdorimin e dhunës së armatosur.

Dy ditë pas zgjedhjeve të 29 qershorit 1997, Berisha bën përpjekjen e parë për të rimarrë pushtetin në mënyrë ilegjitime. Natën e 1 korrikut 1997 ai urdhëroi Gardën e Republikës dhe batalionin e gatshëm të policisë që të bllokoni të gjithë rrugët hyrëse në kryeqytet. Kjo tentative dështoi sepse, për fat të mirë, për urdhrin u njoftua kryeministri i Qeverisë së Pajtimit Kombëtar, Bashkim Fino, i cili e bllokoi ekzekutimin e tij. Përpjekja e fshehtë e Berishës për grusht shteti u pasqyrua edhe nga

shtypi i kohës. Gazeta "Koha Jonë" e datës 3 korrik 1997 hapte faqen e parë të saj me titullin e madh: "Berisha urdhëron grusht shteti!".

Më pas Berisha përdori Leka Zogun, pasardhësin e ish-mbretit, Ahmet Zogu, për të bërë grusht shteti. Referendumi për formën e qeverisjes rezultoi 65 përqind kundër monarkisë. Duket Berisha e bindi Leka Zogun se kishte fituar, por atij i kishin vjedhur votat. Kaq mjaftoi që Leka Zogu, pas një mitingu proteste në sheshin "Skënderbej", në krye të besnikëve të tij dhe të qindra paraushtarakëve e militantëve që i vuri në dispozicion Partia Demokratike, i veshur me uniformën ushtarake e revole në brez, "marshoi" drejt godinës ku ishte vendosur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Turma e armatosur, e udhëhequr prej tij rrethoi edhe godinën e Këshillit të Ministrave dhe Radio Televizionit Shqiptar. Tentativa e Leka Zogut për të pushtuar me forcën e armëve ndërtesën e Komisionit Zgjedhor përfundoi pa sukses, por ajo la pas të vrarë e disa të plagosur.

Më pas, beteja e Berishës, i cili ishte akoma në funksionin e Presidentit të Republikës, vazhdoi me Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ). KQZ i kërkonte presidentit në detyrë që të sqaronte pozicionin e tij sepse, megjithëse akoma president, ishte zgjedhur edhe deputet, funksione që binin ndesh me njëri-tjetrin. Berisha, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe dispozitat kushtetuese që i kishte hartuar vetë, udhëhoqi fushatën elektorale të Partisë Demokratike dhe kishte vënë edhe kandidaturën për deputet në Kuvendin Popullor, të cilën e kishte fituar. Ai vazhdoi t'i ruajë të dy funksionet, deri kur dha dorëheqjen nga posti i presidentit. Insistimi i Berishës për të mbajtur postin e presidentit, edhe pse ishte zgjedhur deputet, i duhej për të vazhduar lojën për të vonuar konstituimin e institucioneve të reja, pas zgjedhjeve parlamentare të 29 qershorit 1997. Megjithëse kishin kaluar shumë ditë nga zgjedhjet, ai vazhdonte të zvarriste dekretimin e hapjes së punimeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, duke vënë në dyshim legjitimitetin e parlamentit të zgjedhur në 29 qershor 1997. Më në fund, më 23 korrik 1997, pas gati një muaji, filloi punimet Kuvendi Popullor.

Në kushtet e reja, Sali Berisha detyrohet të japë dorëheqjen, duke i hapur rrugën zgjedhjes së presidentit të ri. Kuvendi Popullor zgjodhi Rexhep Mejdani si President të Republikës së Shqipërisë. Ai ngarkoi kryetarin e Partisë Socialiste Fatos Nano për formimin e qeverisë. Partia Demokratike dhe lideri i saj, Sali Berisha filluan sërish strategjinë e bllokimit.

Qëndrimi i Partisë Demokratike dhe i liderit të saj, Sali Berisha u ashpërsua me fillimin e vitit 1998. Strategjia e bllokimit, shantazhit ndaj institucioneve të shtetit dhe veprimtaria destruktive u ngrit në një nivel të ri. Një varg aktesh kriminale si në Milot, Kukës etj., në muajt e parë të vitit 1998, kulmuan me ngjarjet e Shkodrës. Në pasditen e datës 22 shkurt 1998, në Shkodër u bë një minigrusht shteti. Ngjarja filloi pas një mitingu të Partisë Demokratike dhe thirrjeve destabilizuese që e shoqëruan atë. Një grup i armatosur sulmoi Drejtorinë e Policisë së Shkodrës. Pasi liroi tridhjetë e pesë të burgosurit që ndodheshin në ambientet e saj, i vuri zjarrin ndërtesës. Grupit terrorist, përveç të burgosurve, iu bashkuan edhe kontigjente të tjera të krimit në Shkodër. Së bashku sulmuan dhe grabitën Bankën e Kursimeve, Bankën Kombëtare, Gjykatën e Prokurorinë, Universitetin "Luigj Gurakuqi", Qendrën "Don Bosko" dhe dogjën Bibliotekën e njohur të qytetit. Ata vendosën kontrollin e tyre mbi institucionet dhe qytetin.

Në 23 gusht 1998, me urdhër të Prokurorisë së Përgjithshme u arrestuan gjashtë ish- funksionarë të lartë të saj, civile e ushtarakë. Ata akuzoheshin për dhunën e ushtruar e vrasjet e bëra ndaj popullsisë civile që protestonte në mënyrë paqësore kundër qeverisë Meksi e ish presidentit Sali

Berisha, përgjegjës për humbjen e parave të tyre në firmat piramidale, të cilat u ngritën e lulëzuan nën bekimin e tyre.

Me burgosjen e gjashtë funksionarëve të lartë të saj, Sali Berisha u ndje i rrezikuar. E kuptonte se pas tyre do t'i vinte radha atij. Ishte ai që kishte urdhëruar për krimet që ishin bërë kundër popullit që protestonte, për të mbrojtur pushtetin e tij. Prandaj reagimi i Partisë Demokratike dhe i vetë Sali Berishës ndaj arrestimit të "të të gjashtëve" ishte i furishëm. Ai deklaroi se arrestimi i tyre ishte dhunim i marrëveshjes politike të 9 marsit të vitit 1997 dhe ata i quajti "viktima të hakmarrjes së Fatos Nanos", Kryeministrit të sapoemëruar.

Një nga elementët e strategjisë së Partisë Demokratike ishte përgatitja e opinionit publik për grushtin e shtetit nëpërmjet dezinformimit.

Çdo ditë në faqet e gazetës "RD", gazetë e Partisë Demokratike, botoheshin informacione sikur gjithë vendi ishte ngritur në revoltë kundër qeverisë: "Tirana, qërohu Nano!", "Korça: ultimatum Nanos!", "Durrësi: Largohu Nano!", "Peshkopia: Revoltë masive kundër Nanos", "Plas revolta në Kuçovë kundër Nanos", "Minatorët kërkojnë rrëzimin e qeverisë"... Pjesë e këtij dezinformimi ishin edhe shifrat që jepeshin për pjesëmarrjen në këto protesta. Ato shumëfishoheshin për të krijuar idenë se i gjithë populli ishte ngritur në revoltë kundër Qeverisë. Duhej formuar opinionin, brenda dhe jashtë vendit, se kundër Qeverisë Nano ishte i gjithë populli dhe se Partia Demokratike ishte interpretuesja e kërkesave të tij për rrëzimin e Nanos e të Qeverisë së tij.

Objektivi kryesor i Strategjisë së Partisë Demokratike ishte destabilizimi i vendit. Politika e saj e mosbindjes civile e kishte kthyer vendin në gjendje lufte. Gazetat kryesore të kohës, në pragun e grushtit të shtetit hapnin faqet e para me lajme të tilla si: "Sulmohet me antitank posta e policisë"; "Luftë në Gjirokastrë: Banorët e Lazaratit bllokojnë rrugën nacionale e hapin zjarr mbi policinë... Partia Demokratike mbështet aktin e kryer nga banorët e Lazaratit"; "Në Mamurras barrikadë në rrugën nacionale. Në krye të protestës deputet i PD, Pal Dajçi"; "Tritol selisë së Partisë Socialiste të Shkodrës dhe më pas i vihet zjarri"; "Tritol shtyllave të tensionit të lartë"; "tritoll ujësjellësve"; "sulmohen e grabiten depot e ushtrisë"...

Fabula e Partisë Demokratike dhe e liderit të saj, Sali Berisha, për ta paraqitur grushtin e shtetit si shpërthim spontan të zemërimit të militantëve të Partisë Demokratike ndaj vrasjes së deputetit Azem Hajdari ishte një farsë. Dy ditë para vrasjes së Azem Hajdarit, në datën 10 shtator 1998 Partia Demokratike i bënte thirrje të hapur militantëve të saj: "Ta rrëzojmë këtë qeveri me çdo mjet". Po u bënte thirrje paramilitarëve dhe militantëve të saj të mprihnin armët se kishte ardhur ora e sulmit kundër shtetit. Po pritej vetëm momenti i përshtatshëm për shpërthimin e grushtit të shtetit. Dhe ai erdhi me vrasjen e Azem Hajdarit, të cilin e nxorri në pritë Sali Berisha. Faktet e kompletojnë kuadrin. Kryefakti janë deklaratimet e vetë Sali Berishës në emisionin "Opinion" në TV Klan, ku me zë, me figurë dhe botërisht deklaroi sesi e çoi Azem Hajdarin para vrasësve të tij.

Grupi hetimor i Prokurorisë së Përgjithshme gjeti në rrethet Shkodër, Elbasan, Fier etj. proces-verbale të përgatitura me kohë nga Partia Demokratike për organizimin e Kryengritjes së Armatosur dhe kryerjen e akteve terroriste.

Grupet e armatosura të Partisë Demokratike të këtyre rretheve me orientim të qendrës, pikërisht në orën 11.00, të datës 14 shtator 1998 kur filloi kryengritja e armatosur në Tiranë (një sinkonizim perfekt) sulmuan institucionet kryesore të shtetit në bazë. Pasi i pushtuan i detyruan titullarët e tyre të firmosnin këto proces-verbale, ku pranonin dorëheqjen nga funksionet e tyre shtetërore dhe i jepnin të drejtën këtyre grupeve të ushtronin kompetencat e tyre pushtetore.

Të gjitha këto fakte tregojnë se grushti i shtetit i 14 shtatorit të vitit 1998 nuk ishte një ngjarje spontane, që e provokoi vrasja e deputetit të Partisë Demokratike, Azem Hajdari. Ai po përgatitej me kohë. Në këtë kuptim, grushti i shtetit i 14 shtatorit të vitit 1998 ishte një ngjarje e paralajmëruar.

Më 12 shtator 1998, pranë selisë së Partisë Demokratike u vra deputeti Azem Hajdari. Bashkë me të edhe një nga rojet e tij, Besim Çerja. Ndërsa u plagos roja tjetër, Zenel Nezaj. Vrasësit e pritën atë gjithë ditën para selisë së Partisë Demokratike, ku ishin shumë të ekspozuar, kur këtë akt mund ta kryenin lehtësisht dhe pa rënë në sy gjatë rrugës së kthimit të tij nga Fieri, ku kishte marrë pjesë në një miting me militantë të Partisë Demokratike.

Pas vrasjes së deputetit Azem Hajdari, kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, shkon në Spitalin Ushtarak, ku ndodhej trupi i pajetë i deputetit Azem Hajdari. Shtypi i kohës shkruan se ai bëri një takim vetëm për vetëm, për rreth një orë me rojen e plagosur, Zenel Nezaj, dëshmitarin e vetëm të ngjarjes, të cilin e inçizoi.

Më pas Sali Berisha është kthyer në selinë e Partisë Demokratike dhe ka zhvilluar një takim me bashkëpunëtorët e tij më të afërt. Lidhur me këtë moment, Izet Haxhia, roja personale e Sali Berishës, dëshmitar okular deklaron: "Pas kthimit nga spitali ushtarak... Berisha ka mbledhur rreth tridhjetë eksponentë të PD dhe u ka thënë që kjo është një vrasje shtetërore e bërë nga Fatos Nano dhe duhet të hakmerremi me çdo çmim. Që atë natë është bërë futja e armëve në selinë e PD-së... ku furnizuesit kryesorë me armë kanë qenë ushtarët e FARK-ut të Bujar Bukoshit" (Izet Haxhia, "Përballë Sali Berishës", fq. 298).

Në mëngjesin e datës 13 shtator 1998 para selisë së Partisë Demokratike mbledhen me qindra simpatizantë të saj për të protestuar për vrasjen e deputetit Azem Hajdari. Partia Demokratike filloi që ta shfrytëzonte ngjarjen për të rritur zemërimin e militantëve kundër Qeverisë, me qëllim që ta përdorte për zhvillimin e grushtit të shtetit që kishte planifikuar. Azem Hajdari gëzonte autoritet tek anëtarët e militantët e Partisë Demokratike, për rolin në demonstratat e studentëve në dhjetor të vitit 1990, që çuan në rrëzimin e diktaturës.

Në krye të protestës ishte njëri nga drejtuesit kryesor të Partisë Demokratike; anëtari i kryesisë së saj, ish kryetari i Kuvendit Popullor, Pjetër Arbnori. Rrugës demonstruesit sulmojnë Ministrinë e Rendit. Pasi dështojnë në përpjekjet e tyre për ta marrë, djegin e shkatërrojnë makinat që ndodheshin të parkuara para Ministrisë së Rendit dhe godasin me sende të forta xhamat e ndërtesës. Më pas turma e militantëve të Partisë Demokratike vazhdojnë rrugën drejt godinës së Kryeministrit. Më pas sulmojnë godinën e Kryeministrit, duke përdorur armët dhe bëjnë përpjekje të futen në ambientet e saj. Ushtarët e Gardës së Republikës dhe policët që ndodheshin akoma në shërbim të saj, bëjnë përpjekje ta mbrojnë. Në këtë konfrontim vritet një nga demonstruesit dhe plagosen disa të tjerë nga të dy palët. Mbrojtësit e godinës tërhiqen.

Turma e militantëve, që sipas shtypit të kohës ishin rreth 1500-2000 vetë, arrin të futet në katin e parë të godinës, ku dhunojnë zyrat dhe ambientet e saj. Më pas, duke parë rezistencën e forcave të gardës dhe policisë që mbronin katet e sipërme të Kryeministrit, u tërhoqën. Kjo ishte prova gjenerale para grushtit të shtetit që do të zhvillohej të nesërmen. Mbasditja e 13 shtatorit në përgjithësi ishte e qetë, por ndihej pezull tensioni i furtunës që po përgatitej për datën 14 shtator 1998.

Në mëngjesin e datës 14 shtator 1998 fillojnë të vijnë militantët e Partisë Demokratike nga rrethet.

Autobusët e tyre rrethojnë sheshin "Skënderbej", ku do të zhvillohej ceremonia mortore e deputetit Azem Hajdari. Ceremonia filloi në ora 11. Në krye të saj lideri i Partisë Demokratike, Sali Berisha. Ajo u karakterizua nga thirrje lufte kundër Qeverisë dhe kryetarit të saj Fatos Nano, që edhe në këtë miting Berisha e quajti vrasësin e deputetit Azem Hajdari.

Pas ceremonisë mortore, turma e paramilitarëve dhe militantëve fanatikë të Partisë Demokratike, rreth 3000 vetë, pjesëmarrës në ceremoninë mortore, me arkivolin me trupin e Azem Hajdarit në supe, në vend që të shkonin në varrezat e Sharrës, ku do të prehej trupi i tij, marshojnë me të në krah, drejt selisë së Këshillit të Ministrave. Ishte pjesë e planit për realizimin e grushtit të shtetit. Lideri i tyre, Sali Berisha, i kishte dhënë vetëm 24 orë kohë Fatos Nanos dhe Qeverisë së tij për të dhënë dorëheqjen.

Në krye të paramilitarëve e turmës së militantëve fanatikë të Partisë Demokratike, ishin drejtuesit kryesorë të saj, me përjashtim të Berishës që pas ceremonisë u kthye në zyrë, ku ndodhej shtabi operativ që udhëhiqte sulmin kundër institucioneve të shtetit. Gjatë rrugës drejt godinës së Këshillit të Ministrave, kur iu afruan Ministrisë së Rendit, sulmuan repartin 324 pranë saj dhe grabitën 100 automatikë, mitraloza dhe granata, me të cilat u armatos pjesa tjetër e militantëve të Partisë Demokratike që po marshonin drejt Kryeministrisë.

Në ora 12.00, turma e armatosur e militantëve të Partisë Demokratike pushtojnë godinën e Këshillit të Ministrave. Ata nuk hasën asnjë rezistencë. Ushtarët e Gardës dhe forcat e rendit, të ngarkuara për mbrojtjen e selisë së Qeverisë, e kishin braktisur godinën. Edhe tanket që dërgoi Garda kundër turmës së armatosur, në të vërtetë ishin nisur për të kompletuar arsenalin e tyre në sulmin kundër institucioneve të shtetit. Ato u morën menjëherë, pa asnjë rezistencë nga turma e armatosur. Hetimet pas grushtit të shtetit treguan se tanket ishin nisur qëllimisht me kapakët të hapur për t'u marrë nga turma e armatosur. Në mënyrë vandale u dhunuan zyrat e ambientet e tjera të selisë së Këshillit të Ministrave. Pasi vodhën pajisjet e zyrave, shkatërruan e i vunë flakën gjithçkaje që gjendej brenda godinës, e cila nuk mund të merrej me vete.

Në ora 13:00 plaçkitet ndërtesa e Kuvendit dhe selia e Kryesisë së Kuvendit. Në ora 13.30 sulmohen Gjykata Kushtetuese, Ministria e Drejtësisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Ministria e Kulturës që ndodheshin në ish godinën e KQ të PPSH. Plaçkitin e shkatërrojnë gjithçka që gjejnë në zyrat e ambientet e tyre. I vetmi institucion që nuk u sulmua ishte Presidenca, megjithëse ndodhej brenda perimetrit të institucioneve kryesore të shtetit. Jo se ajo u harrua, por ishte porosi e Berishës për të mos u prekur.

Siç do të shohim më vonë, ishte brenda planeve të tij. Në ora 14 grupi i paramilitarëve të Partisë Demokratike, i drejtuar nga Izet Haxhia dhe turma e armatosur militantëve të saj me në krye kryetarin e partisë së Legalitetit, Ekrem Spahiu, sulmojnë dhe pushtojnë RTSH. Dhunohen punonjësit e saj e merren peng drejtori i televizionit, Edi Mazi, dhe drejtori i radios, Martin Leka. Ekrem Spahiu deklaroi në televizion: "qeveria dhe të gjithë institucionet e shtetit kishin rënë dhe se demokracia kishte triumfuar në Shqipëri".

Faktori ndërkombëtar nuk e pranoi grushtin e shtetit të Partisë Demokratike. Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara të Amerikës deklaroi prerazi, fill pas konsumimit të grushtit të shtetit, se: "nuk njeh asnjë pushtet që del nga dhuna". Ministri i Punëve të Jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë, Kinkel, deklaroi: "Unë dënoj ashpër çdo përpjekje për të rrëzuar me anë të përdorimit të dhunës qeverinë shqiptare të zgjedhur në mënyrë demokratike".

Qeveria italiane zhvilloi një mbledhje urgjente për ngjarjet në Shqipëri. Kryeministri Romano Prodi deklaroi: "Të ndalet dhuna në Shqipëri". Në këto kushte Berisha urdhëron tërheqjen e paramilitarëve dhe grupeve të militantëve të armatosur të Partisë Demokratike nga institucionet e pushtuara. Pas kësaj fillojnë të dalin rreth orës 16 në rrugët e Tiranës policët e parë. Më pas prania e tyre filloi të shtohet dhe nisin të çlirojnë një pjesë të institucioneve. Forcat e RENEA – as marrin tanket.

Segmente të rëndësishme morën pjesë aktive në sulmin e armatosur kundër institucioneve të shtetit në 14 shtator 1998. Vetëm nga Ministria e Rendit u larguan nga dikasteri pas grushtit të shtetit, pesëdhjetë oficerë të lartë, midis të cilëve edhe drejtorë të drejtorive të dikasterit, sepse kishin refuzuar hapur të mbrojnë institucionin kur ai u sulmua në datën 13 dhe 14 shtator. Në shkallë vendi u larguan pas grushtit të shtetit 110 drejtues të niveleve të ndryshme të forcave të rendit. të diet bashkëpunuan apo iu bashkuan sulmit kundër institucioneve të shtetit në 14 shtator.

Fakte të shumta flasin se në pragun e grushtit të shtetit ka pasur një marrëveshje midis Partisë Demokratike dhe kuadrove drejtuese të policisë në qendër dhe drejtuesve të komisariateve të policisë së Tiranës e të rretheve, Gardës së Republikës dhe SHIK-ut. Me këtë shpjegohet që forcat e tyre, të ngarkuara për mbrojtjen e institucioneve, braktisën detyrën dhe nuk iu kundërvunë grushtit të shtetit.

Sipas kallëzuesit, ka fakte të shumta flasin se institucioni i SHIK - ut ishte komplet jashtë loje në pragun dhe gjatë zhvillimit të grushtit të shtetit. Vetëm dy javë përpara grushtit të shtetit, kur në mbledhjen e Qeverisë së datës 28 gusht 1998 po diskutohej situata e tensionuar që ishte krijuar pas arrestimit të gjashtë drejtuesve të lartë, civilë e ushtarakë të Partisë Demokratike, kryetari i SHIK-ut, në diskutimin e tij deklaronte se: "Situata në shkallë vendi është relativisht e qetë. Këtë kam merakun e parë që dua ti përcjell Këshillit të Ministrave, që të mos konsiderohet që jemi në pragun e një gjullurdie të madhe"?! (Mbledhja e Qeverisë, dt. 28 gusht '98 - Arkivi i Shtetit).

Sipas kallëzuesit, duhet të ketë pasur porosi të forta nga Berisha për të mos u prekur Presidenca, Ka qenë në planet e tij për të përdorur Presidentin për të legjitimuar marrjen e pushtetit me dhunë.

Në paraditen e datës 15 shtator zhvillohet një mbledhje e jashtëzakonshme e Qeverisë për ngjarjet e datës 14 shtator, gjatë së cilës u konsumua grushti i shtetit. Mbledhja, me propozim të kryetarit të Qeverisë, Fatos Nano vendosi: "Të konsiderohen grusht shteti ngjarjet e datës 14 shtator 1998, nëpërmjet të cilave me veprime të organizuara, të dhunshme dhe të armatosura u realizua pushtimi me forcë dhe plaçkitja e ndërtesave të Parlamentit, të Kryesisë së tij, të Kryeministrit, Gjykatës Kushtetuese, Kontrollit të Lartë të Shtetit, të Ministrisë së Financave dhe të Radio Televizionit Shqiptar, si dhe goditja me armë e Ministrisë së Rendit Publik, të nxitura, të organizuara dhe të drejtuara nga Sali Berisha dhe bashkëpunëtorët e tij" (Mbledhja e Qeverisë, 15 shtator '98 - Arkivi i Shtetit).

Prokuroria e Përgjithshme, në përputhje me nenin 221 të Kodit Penal, formuloi akuzën: "Kryengritje e Armatosur..., me synim përmbysjen e rendit kushtetues", si term juridik që përkufizonte grushtin e shtetit. Partia Demokratike dhe lideri i saj Sali Berisha e kundërshtuan atë. Mbështetur në nenin 221 të Kodit Penal, që e përcaktonte si kryengritje të armatosur sulmin mbi institucionet, Prokuroria e Përgjithshme, në datën 16 shtator 1997, i kërkoi Kuvendit Popullor t'i hiqte imunitetin Sali Berishës, si edhe të gjashtë bashkëpunëtorëve të tij të afërt në organizimin e realizimit të grushtit të shtetit. Ajo firmosi njëzet fletë arrestet e para për protagonistët kryesorë të grushtit të shtetit. Në krye të listës Ekerem Spahia, Sali Shehu, Izet Haxhia, Sali Lusha, të cilët

përcaktoheshin si njerëzit më të afërt të Berishës dhe më aktivët në sulmin kundër institucioneve të shtetit në 14 shtator '98. U deklarua gjithashtu se është gati lista e dytë e personave më aktive gjatë zhvillimit të grushtit të shtetit.

Por shumë shpejt, punës së tyre për të kryer në mënyrë të pavarur e profesionale detyrën që iu ngarkua, iu kundërvunë të dy krahët e politikës. Njëra palë, autore e grushtit të shtetit, nëpërmjet presionit e kërcënimit ndaj grupit të prokurorëve që ishin ngarkuar për hetimin e ngjarjes dhe pala tjetër, viktimë e këtij sulmi kriminal, duke u tërhequr e bërë lëshime, si gjithmonë në emër të të ashtuquajturit "paqëtimi të situatës".

Ishte krijuar një atmosferë e përgjithshme bllokimi ndaj grupit të prokurorëve që hetonin ngjarjet e 14 shtatorit. Edhe për të siguruar materialet filmike të sulmit të paramilitarëve e të militantëve të Partisë Demokratike mbi institucionet e shtetit, grupit të hetimit ju deshën ditë, sepse televizionet hezitonin tua jepnin.

Me fillimin e gjyimit, Partia Demokratike vuri në lëvizje gjykatat, që në pjesën më të madhe përbëheshin nga gjyqtarë, ushtarë politikë të tyre.

Prokuroria e Përgjithshme e dërgoi për gjykim dosjen në ngarkim të të pandehurve të implikuar në grushtin e shtetit që në muajin mars të vitit 1999. Gjykata e Tiranës e zvarriti fillimin e procesit të gjyimit disa muaj.

Përfundimisht, ai filloi në 3 qershor të vitit 1999. Prokuroria, në përputhje me Kodin e Procedures Penale, kërkoi gjykim të pandërprerë. Gjykata e Tiranës vendosi që procesi i gjyimit të zhvillohej dy herë në javë. Pjesë e kësaj strategjie zvarritjeje të procesit ishin edhe vetë gjyqtarët. Seancat e gjyimit shtyheshin me javë për shkak të dorëheqjeve apo largimit për "arsye" të ndryshme të anëtarëve të trupit gjykues. Seancat gjyqësore shtyheshin me ditë të tëra edhe për mungesë të avokatëve ditën që zhvilloheshin seancat gjyqësore. Kuadri plotësohej me presionin që bëhej mbi prokurorët e gjyqtarët e çështjes, kur zhvilloheshin seancat gjyqësore.

Rihapja zgjati me vite, sepse Gjykata e Lartë e zvarriti çështjen. Ajo u rihap në vitin 2004, por me disa disavantazhe, si koha që kishte kaluar nga ngjarja, mungesa e figurave të rëndësishme të grushtit të shtetit, të cilët kishin fituar imunitetin e deputetit dhe të tjerëve që kishin pasur kohë të arratiseshin jashtë shtetit. Ai që e organizoi dhe udhëhoqi grushtin e shtetit, Sali Berisha, megjithëse u thërrit nga grupi i hetimit të Prokurorisë së Përgjithshme, nuk u paraqit asnjëherë për të deponuar. Edhe kur po diskutohej ideja për ta sjellë me forcën e ligjit për të deponuar, kryeministri socialist i Qeverisë, Pandeli Majko urdhëroi organet e rendit që, nëse vinte një urdhër i tillë, të mos ekzekutohej.

Si rezultat i të gjithë këtij presioni nga dy krahët e politikës, grupi i hetimit të Prokurorisë së Përgjithshme u shkri dhe procesi i gjyimit vazhdoi të ndiqej vetëm nga një prokuror. Pas ardhjes në pushtet të Partisë Demokratike, u bënë presione të hapura ndaj prokurorit, që vazhdonte të ndiqte me guxim qytetar e profesional procesin e gjyimit, për tërheqjen e dosjes dhe mbylljen e procesit të gjyimit. Për këtë qëllim u vunë në lëvizje kundër tij të gjithë mekanizmat e pushtetit gjyqësor: Prokurori i Përgjithshëm, Këshilli i Prokurorisë e deri tek Presidenti, i cili firmosi largimin e tij nga Prokuroria e Përgjithshme. Përfundimisht, meqenëse prokurori i çështjes nuk pranoi të tërhiqeshin aktet e dosjes dhe të mbyllej procesi i gjyimit, i hoqën të drejtën e ndjekjes së këtij procesi dhe si ndëshkim e transferuan në një nga rrethet periferik të vendit.

Pas kësaj u tërhoq dosja e hetimit, duke e mbyllur përfundimisht procesin e hetimit të grushtit të shtetit të 14 shtatorit të vitit 1998.

Procesi i gjykimit të autorëve dhe ekzekutorëve të grushtit të shtetit të 14 shtatorit, ashtu si procesi i gjykimit të gjashtë funksionarëve të lartë të Partisë Demokratike, përgjegjës për dhunën e vrasjet e bëra ndaj popullit protestues në muajt e parë të vitit 1997, u mbyllën pa asnjë të dënuar. Madje, edhe ata që u burgosën, gjykatat i dëmshpërblyen për të gjithë kohën e qëndrimit në burg.

Për nevoja të verifikimeve paraprake të këtij materiali kallëzues me shkresën nr: 38119 të datës 28.10.2025 i është kërkuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë informacion mbi ecurinë dhe/ose mënyrën e përfundimit të procedimit penal në lidhje me ngjarjet e datës 14.09.1998 ku disa grupe personash të armatosur kanë sulmuar disa nga institucionet kryesore publike të Republikës së Shqipërisë dhe vënien në dispozicion të një kopje të njehsuar me origjinalin të vendimit të marrë.

Me shkresën nr: 28552/1 të datës 05.11.2025 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë ka kthyer përgjigjen duke na dërguar vendimin për pushimin e procedimit penal nr: 2086/1 të vitit 1998 për kryerjen e veprës penale të "Kryengritja", parashikuar nga neni 221 i Kodit Penal si dhe vendimin për pushimin e akuzës të procedimit penal nr: 2086/2 të vitit 1998 për kryerjen e veprës penale të "Kryengritja", parashikuar nga neni 221 i Kodit Penal.

Me vendimin e datës 24.02.2010 për pushimin e akuzës të procedimit penal nr: 2086/2 të vitit 1998 për kryerjen e veprës penale të "Kryengritja", parashikuar nga neni 221 i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurve: Qamil Biberaj, Cen Doçi, Avni Metalia, Sokol Gashi, Gëzim Qordja, Hysni Gjyriqi, Bajram Hidri, Bajram Martini, Uk Çelkola dhe Muharem Boshnjaku, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka disponuar se nuk mund të provohej akuza për kryerjen e veprës penale të "Kryengritja", parashikuar nga neni 221 i Kodit Penal në ngarkim të të pandehurve dhe në Shtator të vitit 2009 ka ndryshuar akuzën në ngarkim të tyre për kryerjen e veprës penale të "Krijimit të turmave të armatosura", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 233 – 25 të Kodit Penal. Vepra penale e kryer prej të pandehurve, që parashikon si sanksion penal dënimin me burgim deri në 10 vjet është konsumuar në datat 13 – 14 Shtator të vitit 1998. *Duke qenë se nga konsumimi i veprës penale kanë kaluar mbi 10 vjet, sipas parashikimeve të nenit 66 të Kodit Penal, ndjekja penale për veprën penale të "Krijimit të turmave të armatosura", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 233 – 25 të Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurve: Qamil Biberaj, Cen Doçi, Avni Metalia, Sokol Gashi, Gëzim Qordja, Hysni Gjyriqi, Bajram Hidri, Bajram Martini, Uk Çelkola dhe Muharem Boshnjaku, nuk mund të vazhdojë pasi janë konsumuar afatet e parashkrimit që prej datës 14.09.1998.*

Me vendimin e datës 24.03.2010 për pushimin e akuzës dhe pushimin e procedimit penal nr: 2086/2 të vitit 1998 për kryerjen e veprës penale të "Kryengritja", parashikuar nga neni 221 i Kodit Penal, ndër të tjera Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka disponuar se: *Duke marrë në konsideratë dhe qëndrimin e Gjykatës së Lartë, çmojmë se akuza e cila është e mbështetur në prova për të pandehurit Ekrem Spahia, Alfons Zeneli, Shemsi Prençi, Antoneta Malaj etj, është ajo e "Krijimit të turmave të armatosura", parashikuar nga neni 233 i Kodit Penal. Nga momenti i konsumimit të kësaj akuze, pra nga data 13 – 14.09.1998 dhe deri më tani kanë kaluar afatet e parashkrimit.* Për sa më lart është vendosur pushimi i akuzës për të pandehurit Ekrem Spahia, Alfons Zeneli, Shemsi Prençi, Antoneta Malaj etj, për veprën penale të "Krijimit të turmave të armatosura", parashikuar nga neni 233 i Kodit Penal si dhe pushimi i procedimit penal nr: 2086/2 i vitit 1998.

Nga analizimi i fakteve të parashtruara në këtë material kallëzues të pretenduara nga kallëzuesi, si dhe të verifikimeve paraprake rezulton se:

Së pari: kallëzimin e tij shtetasi Idajet Beqiri për kryerjen e veprave penale të “Kryengritjes së armatosur”, “Vepra me qëllime terroriste”, “Organizata kriminale” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 221, 230, 333 dhe 334 të Kodit Penal e ka bërë *në ngarkim të shtetasve Sali Berisha, Ritvan Bode, Genc Pollo, Shaban Memia, Pal Dajçi, Ekrem Spahiu, Alfons Zeneli, Artur Bejzade, Frrok Gjini, Dem Dollapi.*

Së dyti: nga aktet e administruara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë rezulton se në *ngarkim të dy të kallëzuarve* nga shtetasi Idajet Beqiri, shtetasit *Ekrem Spahia dhe Alfons Zeneli*, kjo Prokurori më datë 24.03.2010 ka vendosur pushimin e akuzës për kryerjen e *veprës penale të “Krijimit të turmave të armatosura”*, parashikuar nga neni 233 i Kodit Penal dhe jo për kryerjen e veprave penale të kallëzuara nga shtetasi Idajet Beqiri. Për sa më sipër në lidhje me këto dy të kallëzuar, për veprat penale të kallëzuara nga shtetasi Idajet Beqiri, *nuk pezullohen afatet e parashkrimit të ndjekjes penale* sipas parashikimeve të nenit 66 të Kodit Penal të miratuar me ligjin 7895 të datës 27.01.1995, Kod Penal ky në fuqi në momentin e kryerjes së pretenduar të veprave penale nga ana e të kallëzuarve.

Së treti: të kallëzuarit Sali Berisha, Ritvan Bode, Genc Pollo, Shaban Memia, Pal Dajçi, në periudhën e pretenduar nga kallëzuesi se kanë kryer veprat penale të “Kryengritjes së armatosur”, “Vepra me qëllime terroriste”, “Organizata kriminale” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 221, 230, 333 dhe 334 të Kodit Penal, kanë ushtruar detyrën e deputetit dhe dhe për rrjedhojë, sipas parashikimeve të nenit 75/a, gërma “ç” të Kodit të Procedurës Penal hyjnë në kompetencën lëndore të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Së katërti: në ngarkim të shtetasve Sali Berisha, Ritvan Bode, Genc Pollo, Shaban Memia, Pal Dajçi, Ekrem Spahiu, Alfons Zeneli, Artur Bejzade, Frrok Gjini, Dem Dollapi *nuk ka pasur në asnjë moment*, deri në ditën e depozitimit të këtij kallëzimi më datë 23.10.2025, *hetime paraprake, urdhër për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale dhe akuza* për kryerjen e veprave penale të “Kryengritjes së armatosur”, “Vepra me qëllime terroriste”, “Organizata kriminale” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 221, 230, 333 dhe 334 të Kodit Penal.

Së pesti: sipas parashikimeve të neneve 66, 221, 230, 333 dhe 334 të Kodit Penal të miratuar me ligjin 7895 të datës 27.01.1995, Kod Penal ky në fuqi në momentin e kryerjes së pretenduar të veprave penale nga ana e të kallëzuarve rezulton se:

Neni 66. Parashkrimi i ndjekjes penale

Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar:

a) *njëzet vjet për krimet që parashikojnë dënim jo më të ulët se dhjetë vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë;*

b) *dhjetë vjet për krimet që parashikojnë dënim nga pesë gjer në dhjetë vjet burgim;*

- c) pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë;
- ç) tre vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim;
- d) dy vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim me gjobë.

Neni 221. Kryengritja

Pjesëmarrja në veprime masive të dhunshme, si vendosje pengesash apo barrikadash për të ndalur forcat e rendit, rezistenca me armë apo çarmatosja e tyre, pushtimi me forcë i ndërtesave, kryerja e plaçkitjeve, grumbullimi apo vënia në dispozicion e armëve, municioneve dhe njerëzve, krijimi i lehtësirave në favor të kryengritësve, të bëra për të përmbysur rendin kushtetues, *dënohen me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet.*

Marrja pjesë si udhëheqës apo organizator në veprimet e mësipërme *dënohet me burgim të përjetshëm a me vdekje.*

Neni 230. Aktet terroriste

Kryerja e veprimeve të dhunshme ndaj jetës, shëndetit të njerëzve, lirisë vetjake nëpërmjet rrëmbimit të tyre apo të mjeteve të udhëtimit masiv, që kanë për qëllim turbullimin e rëndë të rendit publik dhe ngjalljen e frikës e të pasigurisë në masë, *dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm a me vdekje.*

Neni 333. Krijimi i bandës së armatosur dhe organizatës kriminale

Krijimi i bandës së armatosur apo organizatës kriminale ose pjesëmarrja në to, me qëllim për kryerjen e krimeve, *dënohet nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.*

Neni 334. Kryerja e krimeve nga banda e armatosur dhe organizata kriminale.

I. Kryerja e krimeve nga banda e armatosur apo organizata kriminale do të dënohet sipas dispozitave penale përkatëse duke shtuar dënimin për krimin e kryer edhe me pesë vjet burgim të tjera, kur dispozita referuese përmban dënim me burgim dhe një lloj dënimi më i lehtë, por pa kaluar kufirin maksimal të dënimit me burgim.

II. Kur dispozita përkatëse referuese përmban dënim me burgim apo me burgim të përjetshëm a me vdekje, *dënohet me njëzet e pesë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm a me vdekje.*

III. Kur dispozita përkatëse referuese përmban vetëm dënim me burgim të përjetshëm a me vdekje, *dënohet me burgim të përjetshëm a me vdekje.*

Për sa më lart, rezulton se kryerja e veprave penale të “Kryengritjes së armatosur”, “Vepra me qëllime terroriste”, “Organizata kriminale” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 221, 230, 333 dhe 334 të Kodit Penal, të pretenduara si të kryera nga të kallëzuarit, është konsumuar më datë 14.09.1998 dhe më konkretisht kanë kaluar 27 vjet, 1 muaj dhe 9 ditë nga data 23.10.2025 që është dhe data e depozitimit të kallëzimit penal të shtetasit Idajet Beqiri pranë Prokurorisë së Posaçme.

Sipas parashikimeve të nenit 66, gërma A, të Kodit Penal të miratuar me ligjin 7895 të datës 27.01.1995, Kod Penal ky në fuqi në momentin e kryerjes së pretenduar të veprave penale nga ana e të kallëzuarve;

Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar;

a) **njëzet vjet** për krimet që parashikojnë dënim jo më të ulët se dhjetë vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë;

Për sa më lart, bazuar në nenin 66, gërma A, të Kodit Penal në fuqi në momentin e kryerjes së pretenduar të veprave penale nga ana e të kallëzuarve, nga ana e organit procedues nuk mund të ushtrohet ndjekja penale në ngarkim të shtetasve Sali Berisha, Ritvan Bode, Genc Pollo, Shaban Memia, Pal Dajçi, Ekrem Spahiu, Alfons Zeneli, Artur Bejzade, Frrok Gjini, Dem Dollapi për kryerjen e veprave penale të "Kryengritjes së armatosur", "Vepra me qëllime terroriste", "Organizata kriminale" dhe "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 221, 230, 333 dhe 334 të Kodit Penal, **pasi janë parashkruar afatet e ndjekjes penale.**

Sa më sipër, bazuar në nenin 24, pika 2 dhe nenin 290, gërma "d" të K. Pr. Penale, çmoj se faktet e kallëzuara si vepra penale janë shuar dhe për këtë shkak duhet vendosur mosfillimi i procedimit penal lidhur me kallëzimin penal të depozituar nga shtetasi Idajet Beqiri.

Në analizë të këtij kallëzimi rezulton se ndjekja penale nuk mund të fillojë, pasi pretendimet e shtetasit Idajet Beqiri dhe faktet penale që pretendon ky kallëzues janë shuar dhe nuk përmbajnë elementë të ndonjë vepre tjetër penale të parashikuar nga Kodi Penal.

Për të gjitha këto arsye, duke qenë se nuk provohet ekzistenca e ndonjë fakti penal, në respektim të neneve 290/d dhe 291 të K. Pr. Penale si dhe nenit 66 të Kodit Penal (në fuqi në kohën e pretenduar të kryerjes së veprave penale, sipas arsyetimit më sipër) :

V E N D O S A:

1. Mosfillimin e procedimit penal, për kallëzimin penal nr: 293 të vitit 2025 të depozituar nga shtetasi Idajet Beqiri.
2. Ky vendim i njoftohet kallëzuesit, i cili ka të drejtën e ankimit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 10 ditëve nga marrja dijeni.

PROKURORI

EDVIN KONDILI

